



UNIVERSITETI "KADRI ZEKA" UNIVERSITY
Zija Shemsiu, 60000, Gjilan, Kosovë
www.uni-gjilan.net tel: 0280390112

Ref.nr. 01 / 1637 Dt. 13 / 09 / 2023

Senati i Universitetit Publik "Kadri Zeka" në Gjilan, mbështetur në dispozitat e nenit 8 të Ligjit të Punës, Nr. 03/L-212, dispozitat e nenit 26 të Ligjit mbi Arsimin e Lartë të Kosovës, Nr. 04/L-037, si dhe nenit 47, paragrafi 1 nën paragrafi 1.1.2 të Statutit të Universitetit "Kadri Zeka" Gjilan, dhe Rregullores për procedurat për zgjedhëse lidhur me emërimin, riemërimin dhe avancimin e personelit akademik Ref.nr.01/742 të dt. 28.04.2022, në mbledhjen XLVI të mbajtur më datë 07.09.2023, vendos të shpall:

K O N K U R S

Për emërimin, riemërimin dhe avancimin e personelit të rregullt akademik në Universitetin Publik "Kadri Zeka" Gjilan, për këto Fakultete:

I. FAKULTETI I EDUKIMIT

Një (1) mësimdhënës/e, për lëndët nga fusha e pedagogjisë:

Pedagogjia e edukimit parashkollor (2); Praktika pedagogjike II (2); Strategjitë e edukimit parashkollor (2); Komunikimi në edukim (2) në programet Arsimi Parashkollor dhe Arsimi Fillor; Kurrikula shkollore (3); Mësimi i bazuar në projekte (3) në programin Master Mësimdhënie dhe Kurrikula në Arsimin Fillor.

Një (1) mësimdhënës/e, për lëndët nga fusha e pedagogjisë:

Edukim gjithëpërfshirës (2); Teori e mësimin (2); Zhvillimi i kurrikulave (2); Arsimimi gjatë gjithë jetës (2) në programet Arsimi Parashkollor dhe Arsimi Fillor; Praktikë e mësimdhënies (3); Mësimdhënie në teori dhe praktike (3) në programin Master Mësimdhënie dhe Kurrikula në Arsimin Fillor.

Një (1) mësimdhënës/e, për lëndët nga fusha e psikologjisë:

Psikologji e fëmijës (4); Psikologji e edukimit (4), Psikologji zhvillimore (2); Psikologji e lojës (2); Psikologji e personalitetit (2) në programet Arsimi Parashkollor dhe Arsimi Fillor; Psikologji sociale në programin Master Mësimdhënie dhe Kurrikula në Arsimin Fillor.

II. FAKULTETI JURIDIK

Një (1) mësimdhënës/e, për lëndët:

E drejta e procedurës penale 3 orë (O); Kriminialistika 2 orë (O); Viktimologjia 3 orë (O); Kriminialistika (Master) 2 orë (Z); Krimi i organizuar 2 orë (Z); E drejta e kundërvajtjes (Master) 2 orë (Z); Përgjegjësia penale e personave juridik 2 orë (Z).

Një (1) mësimdhënës/e, për lëndët:

Ekonomia 2 orë (O); Integrimet Ekonomike Evropiane 2 orë (O); Politika Ekonomike 2 orë (O); Menaxhimi i Burime Njerëzore 3 orë (O); E drejta ndërkombëtare ekonomike 3 orë (O); Shteti dhe Qeverisja 2 orë (O).

Një (1) mësimdhënës/e, për lëndët nga fusha kushtetuese administrative:

Klinika juridike administrative 3 orë (O); Sistemet elektorale 3 orë (O); Etika profesionale në qeverisje 2 orë (Z); Ruajtja dhe menaxhimi i informacionit 2 orë (9O); Qeverisja lokale (Z).

III.FAKULTETI EKONOMIK

Një (1) mësimdhënës/e, për lëndët:

Tregjet dhe institucionet financiare; Menaxhimi i riskut dhe sigurimet; Qeverisja korporative; Analiza e investimeve; Ekonomia e Kosovës dhe zhvillimi dhe lëndë të tjera nga fusha e Ekonomiksit.

Një (1) mësimdhënës/e, për grup lëndët:

Menaxhimi i projekteve; Menaxhimi i operacioneve; Menaxhimi i burimeve njerëzore; Menaxhimi i investimeve; Sjellje organizative dhe lëndë të tjera nga fusha e Menaxhmentit.

Një (1) mësimdhënës/e, për lëndët:

Gjuhë Angleze I dhe II me plotësim norme në Fakultetin e Shkencave Kompjuterike.

IV.FAKULTETI I SHKENCAVE KOMPJUTERIKE

Një (1) mësimdhënës/e, për lëndët:

Ueb Teknologjit 2 orë(O); Ueb Shërbimet 2 orë (O); Dizajnimi Multimedia 2 orë (O); Zhvillimi i Ueb Aplikacioneve 2 orë (O); Ueb Dizajn i Avancuar 2 orë (O); Databaza e Avancuar 2 orë (O).

Një (1) mësimdhënës/e, për lëndët:

Arkitektura e kompjuterëve & SO 2 orë (O); Hyrje në grafikën e kompjuterëve 2 orë (O), Tik në Edukimin fillor 2 orë (O), Hyrje në Inteligjencën Artificiale 2 orë (O); Zhvillimet në internet 2 orë (O); Tik në edukimin parafillor 2 orë.

Një (1) mësimdhënës/e, për lëndët:

Databaza (O), Siguria e kualitetit të softuerëve (Z); Vizualizimi dhe procesimi i imazheve (O); Analiza e kërkesave për Webaplikacione (Z); Siguria e rrjetave (O); Data science (O).



Kandidatët të cilët paraqiten në konkurs duhet t'i dorëzojnë këto dokumente:

- Kërkesën;
- Biografinë (CV);
- Kopjen e diplomës të studimeve themelore, masterit dhe doktoratës, të noterizuara (kandidatët e brendshëm të UKZ-së nuk kanë nevojë të sjellin këto dokumente, përveç nëse janë të reja dhe nuk janë sjellë më parë);
- Certifikatën e notave në tri nivelet e studimit (kandidatët e brendshëm të UKZ-së nuk kanë nevojë të sjellin këto dokumente, përveç nëse janë të reja dhe nuk janë sjellë më parë);
- Certifikatën e lindjes;
- Certifikatën e shtetësisë (ose certifikatën për vendbanimin në Republikën e Kosovës) ;
- Dëshmi (kopjet) për punimet shkencore, monografive, teksteve mësimore, publikime në revista ndërkombëtare shkencore ose artistike, pjesëmarrje aktive në konferencat kombëtare dhe ndërkombëtare etj.
- Dëshmi për përvojën e punës në mësimdhënie dhe profesione tjera lidhur me fushën e mësimdhënies në arsimin e lartë;
- Certifikatë nga gjykata, se ndaj tij nuk janë duke u zhvilluar hetime;
- Dëshmi për njohjen e gjuhës së huaj botërore.

Kandidatët që kanë doktoruar ose kanë përfunduar studimet baçelor apo master jashtë vendit duhet të sjellin dëshmi për nostrifikimin e diplomës përkatëse nga MASHT-i .

Kandidatët duhet të sjellin njërin prej këtyre dokumenteve si dëshmi për njohjen e gjuhës së huaj botërore:

- Të kenë të kryer njërin nivel të studimeve në gjuhën e huaj ose certifikatë IELTS, TOEFL, TOEIC apo ndonjë dokument tjetër të vlefshëm.

Kandidatët duhet t'i plotësojnë të gjitha kushtet e parapara me Ligjin për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës Nr.04/L-037, Statutin e Universitetit Publik "Kadri Zeka" Gjilan, (shih:<https://www.uni-gjilan.net/wp-content/uploads/2020/12/STATUTI-I-UNIVERSITETIT-%E2%80%9DKADRI-ZEKA%E2%80%9D-N%C3%8B-GJILAN.pdf>) dhe Rregulloren Nr.01/742 dt.28.04.2022 për procedurat përzgjedhëse lidhur me emërimin, riemërimin dhe avancimin e personelit akademik në UKZ.

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë, nga dita e publikimit në ueb-faqe të universitetit.

Dorëzimi i dokumenteve bëhet nga data **14.09.2023** deri më **28.09.2023** në orën **16.00**.

Kërkesa protokollohet në zyrën e arkivës AZ/04.

Aplikantët duhet të plotësojnë formularin F1 të cilin mund ta shkarkojnë nga ueb-faqja e universitetit, dhe në mënyrë elektronike së bashku me dokumentet e tjera e dërgojnë në info@uni-gjilan.net si dhe i tërë dokumentacioni sjellët në kopje fizike në UKZ.

Aplikacionet e arritura pas afatit dhe ato të pakompletuara nuk do të merren në shqyrtim.

Konkursin mund ta gjeni të publikuar edhe në ueb faqen zyrtare të universitetit:

<http://www.uni-gjilan.net>

